

# BULETIN MUJOR



## Edicioni i parë i Festivalit Kombëtar të Shkencës; Fitues gjimnazi “Zhani Ciko”, Patos

U zhvillua finalja e edicionit të parë të Festivalit Kombëtar të Shkencës, me pjesëmarrjen e 300 shkollave dhe 6000 nxënësve të gjimnazeve nga e gjithë Shqipëria. Tre çmimet e para u fituan nga gjimnazet: “Asim Zeneli”, Gjirokastrë (vendi i tretë), “28 Nëntori”, Shkodër (vendi i dytë) dhe “Zhani Ciko”, Patos (vendi i parë). Projekti fitues i këtij edicioni, “Parku Inteligent i Bletëve”, paraqet një përpjekje për ndërtimin e një ekosistemi funksional, ku ndërthuren të dhënat biologjike dhe digjitale për monitorim mjedisor, edukim STEM dhe zhvillim të ekonomisë lokale.



## Miratohet ligji për krijimin e Agjencisë Kombëtare të Shërbimeve Arsimore

U miratua në Kuvend projektligji “Për krijimin e Agjencisë Kombëtare të Shërbimeve Arsimore”. Krijimi i kësaj agjencie ka për qëllim modernizimin e ofrimit të shërbimeve arsimore në vend dhe sigurimin e aksesit publik në fushën e arsimit të lartë dhe arsimit parauniversitar, si dhe çdo shërbim tjetër të caktuar sipas legjislacionit në fuqi, ndërsa partneriteti me ekspertizën e Qendrës së Vlerësime të Universitetit të Kembrixhit synon të garantojë modernizimin e sistemit të vlerësimeve i cili i përgjigjet standardeve ndërkombëtare dhe nevojave të arsimit në vend.



## Konkursi Kombëtar i Gjuhës Shqipe, shkolla “Edith Durham” fiton edicionin e katërt

U zhvillua finalja e madhe e edicionit të katërt të Konkursit Kombëtar të Gjuhës Shqipe për klasat e nënta, ku në një përballje emocionuese garuan dy shkollat finaliste: “Besëlidhja” nga Lezha dhe “Edith Durham” nga Tirana. Ceremonia u përshëndet nga ministrja e Arsimit Mirela Kumbaro dhe ministri Kosovës për Arsimin dhe Shkencën, Hajrulla Çeku. Shkolla “Edith Durham”, Tiranë, u shpall fituese e këtij edicioni, duke u vlerësuar nga juria me 62 pikë. Në këtë konkurs morën pjesë rreth 7 mijë nxënës dhe 1022 skuadra nga 704 shkolla në të gjithë vendin, ndërsa 20 shkollat më të mira u përballën në fazën kombëtare.



## Programi “Pas shkolle”, dyfishohet pagesa për mësuesit

Këshilli i Ministrave ka miratuar paketën e re të ndryshimeve ligjore për programin “Pas shkolle”, i cili mbështet zgjatjen e kohës së qëndrimit të nxënësve në shkollë. Me vendimin e ri është vendosur dyfishimi i honorarit për orët e zhvilluara jashtë programit të detyrueshëm mësimor, duke e çuar pagesën në 1000 lekë për orë, nga 500 lekë që ishte parashikuar më parë. Gjithashtu, është zgjeruar lista e bashkëpunëtorëve përtej mësuesve të shkollave, duke përfshirë mësues nga lista e pritjes së portalit “Mësues për Shqipërinë”, mësues në pension, si dhe ekspertë e specialistë të fushave të ndryshme, si artet, zejdet, etj.




## Tekste falas dhe të reja çdo vit për gjithë arsimin fillor

Këshilli i Ministrave ka miratuar vendimin për pajisjen me tekste të reja falas për të gjithë arsimin fillor, duke përfshirë edhe klasat e katërta dhe të pesta. Më parë, tekstet falas siguroheshin vetëm për klasat e para, të dyta dhe të treta. Me vendimin e ri, dhe me financim nga Ministria e Arsimit prej rreth 4.3 milionë lekësh të reja, tekstet falas do të shpërndahen çdo vit edhe për nxënësit e klasave të katërta dhe të pesta, që përllogariten në rreth 9 mijë nxënës. Në këtë mënyrë, i gjithë arsimi fillor do të pajiset me paketën e plotë të librave falas, duke garantuar tekste të reja çdo vit për të gjithë nxënësit.



## Hapet Kampusi Ndërkombëtar i Tiranës - ICCT

U përurua hapja e Kampusit Ndërkombëtar të Tiranës (ICCT), fryt i bashkëpunimit mes Universitetit Politeknik të Tiranës (UPT) dhe Universitetit të Teknologjisë së Compiègne në Francë (UTC). Diplomati e dhëna në përfundim të këtyre programeve të studimit lejojnë studime të mëtejshme preferenciale drejt programeve të nivelit master ose programeve të shkollës inxhinierike, veçanërisht brenda UTC dhe UPT. Ky bashkëpunim është zhvilluar me kalimin e viteve përmes mobilitetit të studentëve, shkëmbimeve universitare dhe programeve të dyfishta master.



## Programi Kombëtar i Zhvillimit Profesional 2026-28, trajnohen 20 mijë mësues

Ka nisur Programi Kombëtar i Zhvillimit Profesional të mësuesve 2026–2028, ku do të trajnohen rreth 20 mijë mësues të arsimit parauniversitar. Një cikël trajnimesh i cili do të ofrojë module të reja të edukimit në vazhdim, përputhshmëri më të madhe me kurrikulën e re dhe mbi të gjitha, do t'i pajisë mësuesit me aftësitë që kërkon mësimdhënia në epokën digjitale. Programi i Zhvillimit Profesional të Mësuesve, i financuar nga Ministria e Arsimit, do të realizohet nga Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar në bashkëpunim me pedagogë dhe profesorë në 9 universitete dhe synon të përmirësojë cilësinë e mësimdhënies dhe mësimnxënies.